



ReSPA

Regional School
of Public Administration

Zbulimi i konfliktit të interesave të fshehura

Metodologji për trupat mbikëqyrës dhe aktorë tjerë



ReSPA

Ranka Bartula-Musikic
Menaxhere Programi

Autor

Dr. Tilman Hoppe, LL.M., ekspert anti-korrupsioni, Gjermani.

FALËNDERIME

Autori është falënderues për informacionet e personave vijues që kanë komentuar në versionet e mëhershme. Anëtarët e Grupit të Punës për Etikë dhe Integritet të ReSPA-s; Dr. Radu Cotici, Bosnjë dhe Hercegovinë; Ádám Földes, Gjermani; Dr. Valts Kalniņš, Letoni; Pedro Gomes Pereira, Zvicër; Paul Zoubkov, Gjermani.

ReSPA është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe vendet e Ballkanit Perëndimor që punon në kujdesin dhe përforcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e administratës publike të shteteve anëtare. Ajo synon të ofrojë ngjarje të shkëlqyeshme, inovative dhe kreative të trajnimit, aktivitete të rrjetëzimit, ngritje të kapaciteteve dhe shërbimeve të konsultimit për të siguruar që vlerat e përbashkëta të respektit, tolerancës, bashkëpunimit dhe integritit janë të riafirmuar dhe zbatuar në administratat publike të rajonit.

Ky dokument është hartuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij dokumenti janë përgjegjësi e vetme e ReSPA dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të kuptohet që pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

TË DREJTA TË KOPJIMIT

© Regional School of Public Administration, 2017

Ky publikim është në pronësi të ReSPA-s. Çdo rishtypje e paautorizuar ose përdorim i këtij materiali është i ndaluar.

KONTAKTI

Shkolla Rajonale e Administratës Publike

Branelovica

P.O. Box 31, 81410

Danilovgrad, Mali i Zi

Telefoni: +382 (0)20 817 200

Internet: www.respaweb.eu

E-mail: respa-info@respaweb.eu

PËRMBAJTJA

1	<i>Përse</i> kjo metodologji?	4
2	<i>Çfarë</i> të kërkohet: Skema të fshehjes së konfliktit të interesave	6
	2.1 Mospërputhje	6
	2.2 Konflikte ad-hoc.....	7
	2.3 Skemat transnacionale	8
3	<i>Ku</i> të kërkoni: Strategji kërkimi.....	8
	3.1 Mospërputhje	8
	3.2 Ad-hoc konflikte	9
	3.3 Skemat transnacionale	13
	3.4 Vegla të kërkimit elektronik.....	14
4	<i>Kur</i> të kërkoni: flamuj të kuq dhe nxitësit.....	16
5	<i>Kë</i> duhet të kërkohet: aktorë për zbulimin e konfliktit të interesave	17
	5.1 Organe që verifikojnë deklarata të pronave/interesave.....	18
	5.2 Mbikëqyrësit.....	18
	5.3 Kontrollimi i brendshëm.....	18
	5.4 Revizorë të jashtëm	18
	5.5 Shoqëria civile.....	19
6	<i>Me pak fjalë</i> : 10 parimet	19

1 Përse kjo metodologji?

Konflikti i fshehtë i interesave në sektorin publik është një prej skemave më të shpeshta të korrupsionit, përfshirë edhe shtetet e mëdha të zhvilluara industriale.¹ Prandaj, komuniteti ndërkombëtar ka dedikuar një sërë kërkimesh të mëdha për **parandalimin** e kësaj forme të korrupsionit, për shembull:

- OECD, Menaxhimi i Konfliktit të Interesave në Sektorin Publik, Manual (Vegël) (2005),²
- ADB/OECD, Menaxhimi i Konfliktit të Interesave – Korniza, Manuale dhe Instrumente për Parandalimin, Zbulimin dhe Menaxhimin e Konfliktit të Interesave (2008), 247 faqe;³
- Iniciativa Rajonale për Anti-Korrupsion (RAI), Rregulla dhe Përvoja të Çështjeve të Integritetit (2012), 119 faqe;⁴
- Banka Botërore, Mekanizma të Llogaridhënies Publike (PAM): Vlerësime të përpjekjeve të ligjeve aktuale dhe praktikave të vendeve në kuptim të kufizimeve të konfliktit të interesave (2013), 10 faqe;⁵
- Këshilli i Evropës/Tilman Hoppe, Manuali Ligjor mbi Konfliktin e Interesave (2015), 140 faqe.⁶

Megjithatë, parandalimi është vetëm njëra anë e monedhës. Një sistem efikas i integritetit gjithashtu ka nevojë që **në mënyrë aktive të zbulojë** shumën e rasteve ku parandalimi nuk ka pasur sukses sepse zyrtari publik nuk ka shpalosur konfliktin e tij/saj të interesave. Për të çuditur është nëse manualët mbi konfliktin e interesave ndonjëherë trajtojnë këtë aspektin e zbulimit aktiv, madje nuk përmendet fare. Një publikim prej 247 faqeve madje edhe mban titullin premtues “Korniza, Manuale dhe Instrumente për Parandalimin, **Zbulimin** dhe Menaxhimin e Konfliktit të Interesave”.⁷ Megjithatë, lexuesi nuk gjen aspak ndonjë metodë të këtij publikimi mbi “zbulimin” e konfliktit të interesave.

Kjo Metodologji synon të **mbyll** këtë **zbrazëti**. Kjo Metodologji mundohet të përgjigjet kësaj pyetjeje në vijim: “Si të zbuloni një konflikt interesash që zyrtari publik nuk e ka raportuar?”

Në realitet, deri më tani, në shumë shtete vetëm **një autoritet/aktor** është përgjegjës për zbulimin e konfliktit të fshehur të interesave, që është trupi për etikë ose anti-korrupsion në çdo shtet. Në shumë raste, një trup i integritetit mund të **reagojë** mbi ankesat ose **kontrollon** vetëm deklaratat vjetore për kompletimin e tyre.⁸

¹ Shikoni p.sh. për Australi dhe Zelandë të Re, Deloitte [Bribery and Corruption Survey](#) 2017: “By far the most respondents named undisclosed conflict of interest as the form of corruption they observed.”

² <http://www.oecd.org/gov/ethics/49107986.pdf>.

³ <https://www.oecd.org/site/adboecdanti-corruptioninitiative/40838870.pdf>.

⁴ http://www.rai-see.org/doc/Study-Rules_and_experiences_on_integrity_issues-February_2012.pdf.

⁵ https://agidata.org/Pam/Documents/COI%20Primer_30Sep2013.pdf.

⁶ www.tilman-hoppe.de/Col_toolkit.

⁷ ADB/OECD, Menaxhimi i Konfliktit të Interesave – Korniza, Manuale dhe Instrumente për Parandalimin, **Zbulimin** dhe Menaxhimin e Konfliktit të Interesave, 2008, 247 faqe, www.oecd.org/site/adboecdanti-corruptioninitiative/40838870.pdf (shënim i autorit).

⁸ Raporti për Anti-Korrupsion i Bashkimit Evropian, COM(2014) 38, faqe 12: “Verifikimet e rasteve janë zakonisht formale dhe shpeshherë të kufizuara vetëm në kontrolle administrative. Kapaciteti i monitorimit dhe veglat e duhura për të zhvilluar kontrolle të qëndrueshme shpesh nuk mjaftojnë.”

Qëllimi i kësaj metodologjie është të jep një pasqyrë të plotë për atë se çfarë mund një person të bëjë që të zbulojë konflikt të interesave **në mënyrë proaktive**. Ka një llojllojshmëri të **skemave** për mënyrën si zyrtarët mundohen të fshehin interesat e tyre private – të gjitha këto skema duhet të synohen nga mbikëqyrja. Në kohën e njëjtë, konfliktet e interesave lënë **gjurmë** dhe shumë aktorë të caktuar janë në pozitë për të përdorur këto gjurmë për të zbuluar konflikte të fshehura të interesave.

Në këtë drejtim, kjo metodologji do të përshkruajë:

- **Skemat** e mënyrave si zyrtarët publik i fshehin konfliktet e interesave;
- **Autoritet/aktorë** që mund të luajnë rol në zbulimin e konfliktit të fshehura të interesave;
- **Strategji** që mund të përpilohen për të zbërthyer gjurmimin e interesave private.

Si një produkt i kësaj metodologjie, krijuesit e politikave mund të shohin **legjislaturën** e konfliktit të interesave të tyre me një dritë të re në përmasa me fuqi plotësuese që mund të nevojiten për mbikëqyrje efektive të konfliktit të interesave. ⁹

Kjo metodologji është vazhdim i “**Studimit krahasues – Konflikti i Interesave në Praktikë**” i ReSPA (2015) ¹⁰ dhe të “**Rekomandimeve për Shpalesje të Financave dhe Interesave të Zyrtarëve Publik për Ballkanin Perëndimor**” (2014). ¹¹


Me këtë metodologji shpresohet që do të mund të adaptohen dhe integrohen në mekanizmat e mbikëqyrjes së **trupave të integritetit**, në procedurat standarde për **shërbimin civil** më të gjerë dhe në monitorimin nga **shoqëria civile** të konfliktit të interesave në shërbimin publik.

⁹ Siç thekson “Manuali Ligjor mbi Konfliktin e Interesave” të Këshillit të Evropës: “Me rëndësi është që trupat e revizionit dhe mbikëqyrjes të kenë resurse të mjaftueshme dhe **fuqi** për të ushtruar funksionet e tyre. Kjo në veçanti përfshin qasje të menjëhershme dhe të papenguar në **baza me të dhëna** të shumta dhe çdo dokument dhe regjistër tjetër zyrtar. Trupat e revizionit dhe mbikëqyrjes duhet gjithashtu të kenë fuqi për të përdorur të dhënat publike private të gatshme (p.sh. internet) ose informacionet e dhëna nga personat privat natyral ose personat ligjor në baza vullnetare. Me këto fuqi, një trup i mbikëqyrjes mund për shembull të kontrollojë një përzgjedhje të caktuar të dosjeve të prokurimit dhe të bëjë një krahasim me regjistrin civil, regjistrin afarist dhe informacionet nga autoritetet tatimore, nëse ka ndonjë lidhje mes fituesit të tenderit dhe ndonjë zyrtar publik i autoritetit publik në fjalë.” (ibid, Koment mbi Nenin 17).

¹⁰ <http://www.respaweb.eu/11/library#respa-publications-2015-7>.

¹¹ <http://www.respaweb.eu/11/library#income-and-asset-declarations-comparative-study-113>.

2 Çfarë të kërkohet: Skema të fshehjes së konfliktit të interesave



2.1 Mospërputhje

Mospërputhjet nuk janë aspak si e veçantë një konflikt interesi, por kufizimet e përcaktuar për parandalimin e konfliktit të interesave para se të ndodhin. Me fjalë tjera, mospërputhjet mundohen të minimizojnë rrezikun e konfliktit të interesave. Për shembull, në disa vende (disa kategori të) zyrtarëve publik nuk lejohen të ushtrjnë profesion të dytë ose për ndonjë biznes, sepse ka rrezik të lartë të interesave në profesion ose biznes për konflikt me detyrat publike të zyrtarit. Kufizimi kryesor i përhershëm që gjendet në aspekt ndërkombëtar dhe strategjitë përkatëse të fshehjes janë këto në vijim:

Kufizime në	Strategjia e fshehjes
Vende të dyta pune	Mos deklarimi i vendit të dytë të punës në deklaratën e pronave/interesave; mos deklarimi i vendit të punës në deklaratën tatimore; mos regjistrimi i vendit të punës me sigurimet sociale (nëse vlen).
Biznese	Mos deklarimi i biznesit në deklaratën e pronave/interesave; regjistrimi i biznesit në emër tjetër ose si strukturë ligjore të ndërmjetësimit.
Kontrata me sektorin publik	Mos deklarimi i kontratave në deklaratën e pronave/interesave ose përdorimi i strukturave ligjore si ndërmjetësues.
Anëtarësime	Mos deklarimi i anëtarësimit në deklaratën e pronave/interesave.

Konflikt me pozitat publike	Mos deklarimi i pozitës në deklaratën e pronave/interesave.
Periudha pas punësimit	Mos deklarimi i periudhës së pas punësimit në deklaratën e pronave/interesave; fshehja nga punëdhënësi paraprak; mos deklarimi i në deklaratën tatimore; mos regjistrimi me sigurimet sociale (nëse vlen).
Pjesëmarrja politike	Mos deklarimi i anëtarësisë në deklaratën e pronave/interesave; shmangia e pjesëmarrjes në ngjarje (gjysmë) publike të partisë politike.

2.2 Konflikte ad-hoc


Konfliktet e interesave ad-hoc varen nga situata – zyrtari publik ndodh që të gjendet përkohësisht në pozitën ku ai/ajo mund të zgjerojë interesat e tij/saj private. Për shembull, një inspektor tatimor zhvillon revizion tatimor në një anëtar të familjes.

Kategoritë e interesave privat	Strategjia e fshehjes
Lidhja familjare	Mos shpалosja e ad-hoc lidhjes familjare; mos deklarimi i anëtarëve të familjes në deklaratën e pronave/interesave në mënyrën e duhur; mos deklarimi i bizneseve familjare në deklaratën e pronave/interesave; fshehja e lidhës familjare me ndonjë emër tjetër ose person ligjor.
Lidhje tjera të afërta	Mos shpалosja e ad-hoc lidhjeve personale.
Lidhja afariste	Mos shpалosja e ad-hoc lidhjes afariste; mos deklarimi i biznesit në deklaratën e pronave/interesave; mos regjistrimi i biznesit ose interesat e vërtetë; regjistrimi i biznesit me ndonjë emër tjetër.
Pjesëmarrja politike	Mos deklarimi i pjesëmarrjes politike; mos deklarimi i anëtarësisë në deklaratën e pronave/interesave.
Dhurata	Mos deklarimi i pranimit të dhuratave mbi kufizimet ligjore; maskimi i dhuratës sikur nga burime private; fshehja e dhuratës nga mbikëqyrja publike (mos postimi i udhëtimit të “sponsoruar” në rrjetet sociale).

Një strategji tjetër gjenerike për gjitha interesat private më lartë është rregullimi i gjërave që pjesa zyrtare të zhvillohet nga **ndonjë zyrtar** tjetër por me udhëzime joformale për atë të konfliktit të interesave.

2.3 Skemat transnacionale

Juridiksionet e huaja nuk janë vetëm një zgjedhje tërheqëse për zyrtarët publik që kërkojnë të fshehin të hollat e tyre që kanë ardhur nga burime të korruptuar; shtetet e huaja janë gjithashtu interesante për fshehje të konfliktit të interesave. Për shembull, një ministër që punon me ministrinë e tij/saj do të zbulohet lehtë. Fshehja e këtij biznesi nën pronësinë e ndonjë kompanie tjetër (vendore) është një zgjedhje megjithatë mund të zbulohet nga çdo aktor i interesuar duke ndjekur regjistrin vendor të kompanive. Fshehja e këtij biznesi nën një ose disa shtresave të strukturave të huaja ligjore është një alternative më efektive. Një organ vendor i mbikëqyrjes mund mos të ketë fuqi për të kontrolluar bazat e huaja me të dhëna dhe këto mund mos të jenë me qasje publike, nëse përveç shkaqeve të gjuhës, ose për shkak se baza me të dhëna gjendet në një vend jo-transparent (“vend jashtë bregut”).



Ka në fakt dy lloje të skemave në të cilat mund të përfshihen vendet e huaja:

- Mospërputhje: Zyrtari publik posedon një biznes të huaj ose ka të ardhura nga ndonjë pozitë jashtë vendit dhe nuk e shpalos.
- Ad-hoc konflikte: Zyrtari publik (ose familja e tij/saj ose farefis tjetër) posedon biznes vendor, e fsheh pas një strukture të huaj ligjore dhe angazhohet në situatë të konfliktit të interesave, siç është prokurimi i biznesit nga punëdhënësi i tij/saj.

3 Ku të kërkonte: Strategji kërkimi

3.1 Mospërputhje

Strategjia e kërkimit për zbulimin e mospërputhjeve ka pika të ngjashme me revizionin financiar të deklaratave të pronave. Trupi i mbikëqyrjes krahason të dhënat e përmbajtura në deklaratën vjetore të zyrtarit publik me të dhënat e përmbajtur në bazat me të dhëna publike dhe private siç janë ato të kompanive, bizneseve, tatimore, regjistri civil (anëtarë të familjes). Trupi i mbikëqyrjes mund në përgjithësi të zbulojë anëtarësime të padeklaruar duke kërkuar internetin për lista të

anëtarësimeve ose për informacione sekondare (p.sh. siç janë deklarata për shtyp ose ndonjë raport për shoqatën përkatëse që përmend anëtarësimin e zyrtarit publik).

Më poshtë kemi listën e bazave me të dhëna dhe mospërputhjet që mund të zbulohen në bazë të të dhënave të tyre. Mund të vërehet qartë që ekzistenca dhe qasja në këto baza me të dhëna varet nga kushtet e secilit shtet në veçanti:

Baza me të dhëna	Mospërputhja relevante
Autoritetet tatimore	Të ardhura plotësuese, pronësi të biznesit, pagesa për anëtarësim në parti politike, pozitë të dytë publike, punësime të dyta ose punësime pasi largimit nga zyra.
Regjistri civil	Qarqe të anëtarëve të familjes për të identifikuar nëse ka shkelje kundër kufizimeve mbi pronësinë e biznesit nga anëtarët e familjes.
Regjistri i bizneseve	Shkelje të kufizimeve për pronësi të biznesit.
Regjistri i kompanive	Shkelje të kufizimeve për pronësi të biznesit.
Regjistra të patentave/regjistrave	Shkelje të kufizimeve për pronësi të biznesit.

Pjesëmarrjet politike nuk mund të zbulohen lehtë. Zakonisht, nuk ka ndonjë bazë me të dhëna për anëtarësi në parti politike, përveç për anëtarësimin e brendshëm dhe privat të cilat i posedojnë partitë politike.

Përveç kësaj, duhet të zhvillohet një kërkim kreativ i të dhënave të lëshuara në **internet**. Ka udhëzime të mira të gatshme për mënyrën e zbulimit të informacioneve të fshehura: për shembull “Zbulimi i të padukurës” nga Kolektivi Taktik Teknologjik¹² ose “Veglat e Forenzikës Digjitale të Bellingcat”¹³

3.2 Ad-hoc konflikte

Një konflikt i interesave ndodh kur një “interes privat” i zyrtarit publik “ndikon ose duket që të ndikojë, performancën e paanshme dhe objektive të detyrave zyrtare të tij ose saj [interesi publik]”.¹⁴ Fshehja e një konflikti të interesave nënkupton: fshehja e interesave private dhe fshehja që lidhet me detyrat publike të zyrtarit publik. Si interesi privat ashtu dhe ndërlidhja me detyrat publike të zyrtarit janë të panjohura. Andaj, për zbulimin, duhet të punohet nga dy skajet:

- Identifikimi dhe hartimi i gjitha **interesave private** të zyrtarit privat. Interesat private nuk janë fizike por “vetëm në zemër” të personave të përfshirë. Padyshim, ata lënë gjurmë – në dosjet e zyrës, bazat me të dhëna, rrjete sociale, etj.


¹² <https://exposingtheinvisible.org/>.

¹³ <https://docs.google.com/document/d/1BfLPJpRtyq4RFtHJoNpvWQjmGnyVkfE2HYoICKOGguA/edit>.

¹⁴ Neni 13, paragrafi 1 i Këshillit të Evropës mbi [Rekomandimin Nr. R \(2000\) 10](#) i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi kodet e zbatimit për zyrtarët publik.

- Kërkimi i **vendimeve të vendit të punës** së zyrtarit publik për aktorët me të cilët gjoja se mund të ketë interesa publike.

Duke punuar nga sy skajet, duhet të kërkohen lidhjet mes interesave private të zyrtarit dhe performanca e tij/saj në vendin e punës:



3.2.1 Pika e nisjes 1: Harta e interesave private

Hapi i parë është përpilimi i harte me të cilën tregohet se cilët aktorë mund të kenë interes privat me zyrtarin publik. Për identifikimin e këtyre aktorëve, mos mendoni vetëm emrat. Emrat e aktorëve janë të rëndësishëm, por jo të jenë identifikuesit e vetëm; me rëndësi të njëjtë janë edhe adresat dhe numrat tatimor, madje edhe nëse nuk dihet emri. Një shembull është adresa e shtëpisë së zyrtarit publik – çdo anëtar i amvisërisë mund të përfaqësojë interes privat i zyrtarit publik; Ndonëse emrat e tyre nuk janë të njohur, adresa e tyre është. Vetëm duke përdorur këtë adresë, mund të identifikohen interesat private.

Shembull:

Zyrtari publik punon si profesor në fakultet juridik. Për një revizion të konfliktit të interesave, mund të kërkohen listat e studentëve që hyjnë në provimin e fundit duke përdorur adresën e shtëpisë së profesorit. Çdo përputhje mund të shpie drejt një anëtari të familjes së profesorit ose partnerit, dhe mund të shkaktohet konflikti i interesave për profesorin në lidhje me provimin përkatës së studentit.

Burimet më poshtë mund të sigurojnë identifikues për interesa private:

Kategoria	Burimi i të dhënave
Anëtarë të familjes	Regjistri civil, rrjetet sociale, adresa e regjistruar e zyrtarit publik ose shtëpia (për anëtarët e familjes)
Lidhje tjera të afërta	Ueb faqe që lidhin zyrtarin publik dhe personin të kenë lidhje të afërt (një kërkim i rastit i emrit të zyrtarit publik, rrjetet

	sociale); adresa e regjistruar e zyrtarit publik ose shtëpia (për anëtarët e familjes); regjistri i pronave, regjistri i autorizimeve.
Biznese	Baza tatimore me të dhëna, regjistrat e kompanive, regjistrat e pronave intelektuale, interneti, rrjetet sociale, regjistri i autorizimeve.
Pjesëmarrja politike	Baza me të dhëna tatimore (pagesa për pjesëmarrje politike – nëse largohen nga tatimi), baza me të dhëna të donacioneve politike, rrjete sociale, interneti.

Siç përmendëm më lartë, nuk duhet të zhvillojë një kërkim kreativ i të dhënave të lëshuar nga **internet**. Ka udhëzime të mira të gatshme për mënyrën e zbulimit të informacioneve të fshehura: për shembull “Zbulimi i të padukurës” nga Kolektivi Taktik i Teknologjik¹⁵ ose “Veglat e Forenzikës Digjitale të Bellngat”.¹⁶

Rezultatet e **hartës** në një listë të emrave dhe identifikuesve tjerë të mundshëm, siç janë adresat ose numrat tatimor. Këto sigurojnë terme të kërkimit për hapin e dytë: Në hapin e dytë, duhet të kërkohen të dhënat e punës së zyrtarit publik për secilin prej këtyre termeve. Çdo përputhje pozitive duhet të përfshijë një shqyrtim të hollësishëm për mënyrën si detyrat zyrtare të zyrtarit ndërlidhen me interesat private.

Më poshtë kemi një listë fillestare të bazave me të dhëna prej të cilave mund të kërkohet përputhje me identifikues të interesave private:

Baza me të dhëna	Interesi i mundshëm privat
Baza me të dhëna e resurseve njerëzore (lista e stafit)	Punësimi i anëtarëve të familjes ose persona të afërt
Dhënia e tenderëve (prokurimi)	Prokurimi nga anëtari i familjes, persona të afërt ose biznese të lidhur me zyrtarin
Bazat me të dhëna tatimore	Vendime ose revizione nga inspektorë tatimor në lidhje me persona të afërt ose biznese
Licenca (patentë shoferin, licenca afariste, leje për ndërtim, etj.)	Dhënia e licencave të personave të afërt ose bizneseve
Regjistra arsimor (pranime, provime, etj.)	Favorizimi i personave të afërt në pranime ose provime
Doganat (baza me të dhëna e inspektimeve)	Favorizimi i personave ose bizneseve të

¹⁵ <https://exposingtheinvisible.org/>.

¹⁶ <https://docs.google.com/document/d/1BfLPJpRtyq4RFtHJoNpvWQjmGnyVkfE2HYolCKOGguA/edit>.

	afërt
Baza me të dhëna për vendime të zonave (p.sh. në komuna)	Përditësimi i vlerës së tokës së zyrtarit publik, të personave të afërt ose bizneseve të tyre
Bazat me të dhëna të pacientëve (spitale, sigurime)	Trajtim i favorizuar i personave të afërt
Baza me të dhëna për rastet gjyqësore	Raste të vendosur nga prokuror ose gjykatës i lidhur me personat të afërt ose bizneseve të tyre
Çdo arkiv i dosjeve me letër	Çdo interes privat

Dhuratat janë raste speciale: Shumë dhurata janë të prekshme megjithatë nuk lënë asnjë gjurmë në asnjë bazë me të dhëna, si dhurata “të vogla” (verë, stilolapsa, orë, etj.). Nëse dhuratat janë mjaft të mëdha që të shënohen në deklaratën e pronave siç janë vetura ose prona të patundura, nëse mund të zbulohen gjatë revizionit financiar të deklaratës nëse nuk janë deklaruar ose burimi i tyre është fshehur. Disa dhurata janë të paprekshme, siç janë ftesë për darkë ose ftesë për një udhëtim çlodhjeje për fundjavë. Këto dhurata zakonisht mund të zbulohen në mënyrë aktive duke kontrolluar për gjurmë në rrjetet sociale. Si përmbledhje: Zbulimi i dhuratave të pranuar dhe padeklaruara varet shumë nga njoftimi nga ndonjë informator (kolegë, qytetar). Nëse është shumë e madhe, dhurata mund të zbulohet në mënyrë aktive duke përdorur metodat e revizioneve financiare.

3.2.2 Pika e nisjes 2: Të dhënat e punës së zyrtarit publik

Kjo strategji kërkimi nuk fillon me një hartë të interesave private, por një hartë të vendimeve të zyrtarit publik që ka marrë në zyrë. Në fillim, duhet të kërkohen vendimet që janë të **jashtëzakonshme**, për shkak të vlerës financiare (p.sh. dhënie të prokurimit, zhvendosja e zonave të tokave, etj.), në kuadër të drejtave që jep një aktori privat (p.sh. afati i licencës, anëtarësimi në trup publik, etj.). Duhet të kontrollohen së paku pesë mostra të këtyre vendimeve të jashtëzakonshme: A përfiton ndonjë prej aktorëve nga vendimi publik i lidhur me zyrtarin publik me anë të interesave private? Për këtë, duhet të merren identifikuesit e aktorëve (emrat, adresat, numrat tatimor) dhe mundohuni të lidhni këtë me zyrtarin publik.

Shembull:

Kompania Z ka fituar një tender të madh nga Ministria e Arsimit. Një kontroll prapavije të Kompanisë Z zbulon që z. G është një prej pronarëve. Një kontroll i regjistrimit të kompanisë zbulon që z. G posedon një biznes tjetër, Kompaninë U. Sipas bazës me të dhëna të financave politike, Kompania U ka dhënë një kontribut të madh për fushatën zgjedhore të Zëvendës Ministrit të Arsimit.

Zakonisht, shumica e konfliktit të interesave të fshehura kanë të bëjnë me vendime të përditshme: një vendim gjyqësor në gjyq, vendimi për të tërhequr akuzat, leje për ndërtim, prokurim i vogël ose

punësimi i ndonjë personi në ministri. Për këtë arsye, duhet të lejohet një kontroll i **mostrës së rastësishme** të vendimeve dhe të zhvilloni një kontroll të prapavijës për aktorët e përfshirë.¹⁷

Ngjashëm me rastet e deklaratave tatimore¹⁸ ka verifikime të synuara dhe rastësishme të deklaratave të pronave/interesave. Për shembull, aty ku GRECO ka gjetur mekanizma të verifikimit që mungojnë, rekomandohet “bashkimi i sistemit të shpalosjes me një mekanizëm efektiv të kontrollit (përfshirë edhe verifikimet e rastësishme)”.¹⁹

Kur bëhet fjalë për bazat me të dhëna dhe burimet e vendimeve të zyrtarëve publik, vlen e njëjta sikur në pjesën “Pika e nisjes 1”.

Me rëndësi është të kontrollohet nëse zyrtari publik ka vepruar në sajë të **detyrave** të tij/saj të përcaktuar me rregullat e brendshme. Nëse jo, kjo mund të jetë një indikacion që zyrtari publik ka vepruar në emër të kolegut (dhe udhëzime) për të fshehur konfliktin e interesave të kolegut.

3.3 Skemat transnacionale

3.3.1 Mospërputhje

Për mospërputhjet, strategjia e kërkimit është e njëjtë sikur me mospërputhjet vendore, përveç atë që duhet të kontrolloj bazat me të dhëna **të huaja**. Kjo parashtron dy sfida:

- E para, duhet të ketë qasje të bazën me të dhëna jashtë vendit.
- E dyta, nuk mund të dimë se në cilën prej 195 vendeve zyrtari publik zhvillon bizneset ose ushtron profesionin (p.sh. konsulencë), duke marrë parasysh që ai/ajo është i ndaluar të bëjë këtë.

Qasja jashtë: Mënyra më e lehtë e qasjes është **të dhënat e hapura**. Shumë baza me të dhëna jashtë vendit janë të gatshme në internet, disa prej tyre madje edhe në gjuhë ndërkombëtare ose rajonale që kuptohet, siç është në gjuhën anglishte. Përveç kësaj, shënimi i termeve kryesore në një faqe kërkimi në internet mund shpesh të jep rezultate të habitshme pozitive. Mund të kalohen barrierat e gjuhës duke përdorur veglat e përkthimit automatik (p.sh. *google translate*).

Aty ku nuk ka baza me të dhëna në internet, trupat e mbikëqyrjes zakonisht kanë nevojë për **marrëveshje** formale ose informale me shtetin tjetër. Për këtë, është hartuar një marrëveshje multilaterale²⁰ dhe Komisioni Evropian ka rekomanduar miratimin përkatës.

Përzgjedhja e vendit: Për kërkimet **në internet**, zakonisht çdo informacion lidhur me termet kryesore do të paraqitet në çdo shtet deri sa ueb faqja përkatëse përmban termet kryesore në

¹⁷ Për revizione të rastit sipas standardeve ndërkombëtare, shikoni për shembull: OECD, [Përdorimi i Programeve të Revizionit](#) (2004), 51 faqe; GRECO Raporti i Vlerësimit Bosnjë dhe Hercegovinë ([Eval IV Rep \(2015\) 2E](#)), rekomandimi v: Rekomandohet “bashkimi i sistemit të shpalosjes me një mekanizëm efektiv të kontrollit (përfshirë edhe verifikime të rastit)”.

¹⁸ Shikoni për shembull: OECD, [Përdorimi i Programeve të Revizionit](#) (2004), 51 faqe.

¹⁹ Shikoni për shembull GRECO Raporti i Vlerësimit Bosnjë dhe Hercegovinë ([Eval IV Rep \(2015\) 2E](#)), rekomandimi v.

²⁰ Shikoni RAI [ueb faqen](#) në bashkëpunim me dhe zbatimin e përpjekjeve të ngjashme nga ReSPA ([Studim fizibiliteti](#) 2014); [Deklaratë për shtyp](#) (12 korrik 2017) nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë për rezultatet e Samtit në Trieste.

alfabetin e njëjtë. Për shembull, një ueb faqe ruse mund të theksojë emrat në anglisht në alfabetin latin ose të përshkruajë.

Për qasje në **bazat me të dhëna** të kufizuara, nuk mund të kërkojmë nga 195 vende të kontrollojnë vetëm një zyrtar, nëse ka ndonjë përputhje me ndonjë prej bazave me të dhëna (195 vende të shumëzuar me 10 ose më tepër). Megjithatë, mund të bëjmë një kontroll të rastit në një numër të caktuar të vendeve ku ka gjasa të mëdha për transaksione ndërkuftare. Për shembull, Moldavia dhe Rumania kanë gjuhën e njëjtë dhe mund të kenë shumë lidhje ndërkuftare me biznese, familje dhe bashkëpunim shtetëror.

Disa baza me të dhëna të huaja mund të kërkojnë pagesë për **përdorimin e bazës**. Për këtë, trupat e mbikëqyrjes duhet të kenë bazë ligjore²¹ dhe një buxhet të vogël për të mbuluar këto pagesa. Zakonisht këto pagesa mund të bëhen vetëm me kartë kredi dhe/ose me shërbime si PayPal. Trupi i mbikëqyrjes nuk ka nevojë për qasje për këto shërbime të pagesës.

Çdoherë që konflikti i interesave përfshin një dyshim të **larjes së parave**, rrjeti ndërkombëtar i Njësive të Inteligjencës Financiare (FIU) mund të përdoret për shkëmbimin e të dhënave në permassa ndërkuftare. Duhet të theksohet që në disa prej vendeve verifikimi i deklaratave bëhet nga FIU, siç janë një pjesë e madhe e deklaratave të pronësisë në Greqi.

3.3.2 Ad-hoc konflikte

Përfshirja e një kompanie të panjohur, jo-transparente dhe të huaj duhet të jetë flamur i kuq për aktivizimin e një kontrolli të hollësishëm të prapavijës: Kush është pronar i kompanisë së huaj? Cilat kompani tjera kompania e huaj i ka në pronësi dhe a ka ndonjë pjesë zyrtari vendor publik?

Shembull:

Ministria e Transportit ka dhënë tender një kontratë të madhe për furnizimin e 12 tramvajeve për kryeqytetin. I jep kontratën Kompanisë Q nga vendi fqinj. Një kontroll i prapavijës së Kompanisë Q bëhet në regjistrin e kompanisë së huaj. Të dhënat tregojnë që Kompania Q është në pronësi të kompanisë vendore. Pronari i kompanisë vendore është z. W që jeton në vendin fqinje. Të dhënat nga regjistri i civil i të huajve tregojnë që z. W është martuar me kreun e departamentit të Ministrisë së Transportit.

Shembulli tregon që mund të ketë lidhje ndërkuftare duke përfshirë një interes privat, siç janë ato lidhet familjare ose të afërt. Të dhënat nga interneti (ueb faqja e kompanisë, regjistrat e kompanisë së huaj) dhe rrjeti social mund të jenë një dobi e madhe për identifikimin e këtyre relacioneve.

3.4 Vegla të kërkimit elektronik

Shihet qartë që çdo kërkim për interesat private lidhur me zyrtar publik bëhet në mënyre më efikase aty ku të dhënat mund të kërkohen në formë elektronike dhe softuer të gatshëm për të mbështetur çdo kërkim. Sektori privat ka përfituar gjatë kohë nga këto vegla të kërkimit

²¹ Shikoni për shembull Aktin Nënligjor Nr. 201/30069 të 2017 të Ukrainës (Ministria e Drejtësisë), Kapitulli III, seksioni 11, pjesa 2: “Për të verifikuar informacionet mbi entitetet e deklarimit të referuar në deklaratën, Agjencia Kombëtare ka të drejtë të marrë informacione nga bazat me të dhëna publike, regjistra të shteteve të huaja, përfshirë edhe pagesën e një shume për të marrë ndonjë informacione në përputhje me Ligjin, nëse kjo pagesë është e nevojshme për të marrë qasje në informacionin”.

elektronik.²² Në veçanti kompanitë e mëdha të revizionit përdorin softuer special për të kërkuar bazat me të dhëna ekzistuese për përputhje, për shembull mes të punësuarve dhe shitësve.²³

Employee Name	Employee Address	Home Phone	Vendor Name	Vendor Address	Phone	YTD Paid
Bristol, Jim J	30 Dean Wells Ct	6394565896	STONE GRASS COMPANY LLC	30 DEAN WELLS COURT	6394565896	\$980
Bunton, Susie F	600 N Church	6557833693	COLD CREEK MACHINE & TOOL	600 NORTH CHURCH ST	6557833693	\$2,507
Smith, Debra A	2180 Millhaven Court	3146539490	HAZELWOOD EAST GRADUATION	ATTN DEBRA SMITH 11300 DUNN	3146539490	\$9,765
Fehrenbacher, Jimmy	2115 N 600TH ST	6187522791	FEHRENBACHER CARPENTRY	2705 NORTH 600TH ST	6187522791	\$5,674
Slider, Kim E	2 Meppen Drive	3338429601	LAW OFFICE OF KIM E SLIDER LL	4 MEPPEN DRIVE	3338429601	\$15,350
Lopinotis, Douglas S	1702 N. 17th	6182772146	LOPINOTIS COMMUNICATIONS IN	26 LISA LANE	6182772146	\$700,000
Woodsmith, Michael G	1388 Jones Place	5735927709	MICHAEL GENE WOODSMITH	P O BOX 1233	5735927709	\$56,780
Wright, Kipper D	2222 W. 9th	6362392289	CUB SCOUT Pack 444	ATTN KIPPER WRIGHT 2222 W 9TH	6362392289	\$500

Përdorimi i kësaj vegje varet nga cilësia e bazave publike me të dhëna. Disa prej çështjeve në këtë drejtim janë:

- A janë të dhënat **të lexueshme nga makina**? Një “bazë me të dhëna” vetëm me një përbërje të dosjeve me fotografi të formave të skanuara nuk do të jetë dobi e madhe, përveç nëse pamjet e dosjeve mund të renditen sipas emrave të personave. Në këto raste, pamjet duhet të marrin trajtim përkatës, që ju lejon të jenë të kërkuar (p.sh. njohja optike e karaktereve – OCR).
- Me cilët **identifikues** mund të kërkohen bazat me të dhëna? Ndonjëherë bazat me të dhëna nuk lejojnë kërkimin sipas emrit, por vetëm sipas veçorive teknike (p.sh. sipas vendit të pronës, jo sipas emrit). Një zgjidhje e mundshme në këtë kontekst mund të jetë nxjerrja e të dhënave të papërpunuar në format të kërkueshëm dhe pastaj të përdoret softueri për kërkim.
- A janë identifikuesit jo të **dykuptimtë**? Emri dhe mbiemri zakonisht nuk mjaftojnë për të identifikuar një person individual. Duhet zakonisht të shtohet edhe një identifikues tjetër, ose elektronik, ose manual pasi të jenë gjetur disa përputhje me emrin e njëjtë.
- A janë ndryshuar identifikuesit me kalimin e **kohës**? Ndonjëherë sistemi i numërimit siç janë të pasaportave dhe kompanive ndryshon me kalimin e kohës. Si rezultat, ai/ajo dhe i njëjti person natyral ose ligjor mund të regjistrohet me dy numra të ndryshëm në baza të ndryshme me të dhëna, varësisht nga koha dhe të dhënat që janë shënuar.
- Sa të **besueshme** janë të dhënat? Duhet marrë parasysh që të dhënat mund të jenë të shënuar me gabime ose që sasi të mëdha të informacioneve mund të mungojnë. Mund të

²² FSS (2017), [Praktika më të mira për Punëdhënës: Konflikti i interesave](#): “Shpeshherë theksohet që relacionet janë vështirë për të zbuluar, por në realitet, konfliktet pothuaj se çdoherë lënë gjurmë që mund të zbulohen me teknikat e kërkimit të të dhënave elektronike. Jo vetëm për zbulimin, por më tepër vlen për identifikimin e relacioneve”; Java e Përputhjes (2014), [A nuk është ajo konflikt? Roli i Revizorit të Brendshëm për Kontrollimin e Palëve Përkatëse](#): “Me shpesh unë shoh përdorimin e teknologjisë analitike që del si vegël për të zbuluar konflikt potencial të interesave. Mund të bëhet një përputhje e të dhënave mes të punësuarit dhe shitësit dhe dosjeve të tyre për të identifikuar lidhjet që sugjerojnë konflikt të mundshëm të interesave. Përputhja do të kërkojë të punësuar dhe shitës me adresë të njëjtë, numër tatimor ose llogari bankare”.

²³ Fotografia “Të dhënat e përputhjes mes shitësit/të punësuarit – Analizë kundër mashtrimit dhe zbulime elektronike nga Deloitte”, marrë nga: Jean Villedieu (28 prill 2014), Zbulimi i mashtrimit: identifikimi i konfliktit të interesave me grafikë <https://linkurio.us/blog/fraud-detection-identifying-conflicts-of-interest-with-graphs/>.

ketë edhe pozitivë falso në sajë të mostrës së të dhënave të kërkuara. Ky aspekt është i rëndësishëm sepse nuk mund të mbështetemi në rezultate negative të kërimit: Duhet të plotësohet kërkiti elektronik në lidhje me të dhënat që mungojnë ose përputhjet që mungojnë (p.sh. duke kontrolluar një mostër të rastit që nuk gjendet në bazën me të dhëna por vetëm në letër).

Në raste konkrete, softueri i përdorur për zbulimin e konfliktit të interesave në sektorin privat nuk përdoret mjaftueshëm në sektorin publik (jashtë kompanive që janë në pronësi të shtetit). Provimi, zhvillimi ose blerja e këtij softueri është një fushë në të cilën donatorët e huaj mund të përqendrojnë ndihmën e tyre.

4 **Kur të kërkon: flamuj të kuq dhe nxitësit**

Nuk mund të zhvillohet një “revizion i konfliktit të interesave” i hollësishëm mbi gjithë zyrtarët publik ose vetëm për një pjesë të konsiderueshme të tyre. Duke marrë nga Pika e Nisjes 1 dhe 2 të strategjive të përmendura të kërimit (shikoni Kapitullin 3), ajo kërkon resurse njerëzore madje edhe nëse ka mbështetje nga veglat elektronike të kërimit. Andaj, duhet të vendosen në prioritet revizionet dhe të fillohen veçanërisht sipas bazave vijuese:

- Një zgjedhje e **rastësishme** (“lotari”) të një përqindjeje të zyrtarëve publik çdo vit (p.sh. 4%);
 - Raporte **mediatike** për dyshime.
 - **Ankesa** të mbështetura për shkelje të konfliktit të interesave (të hapura dhe anonime);
 - Verifikimi i deklaratave vjetore shpalos:
 - o **Deklarata të paplota**: Zyrtari publik nuk ka deklaruar një gjë që mund të përbëjë ose ndërlidhet me interes privat (një anëtar i familjes, biznes ose pronë në pronësi të zyrtarit ose anëtarit të familjes së tij/saj, etj.);
 - o **Pasuri e paligjshme ose pasqaruar**: Stili i jetës (rrjedhja financiare e shpenzimeve) nuk mbështetet nga të ardhurat (rrjedhat financiare të të ardhurave);
 - o Stili i jetës mbështetet nga të ardhurat, por ka të ardhura **të pazakonta** “ligjore” siç janë nga
 - Marrëveshje për tokë,
 - Zhvillimi i tokës,
 - Të ardhurat nga biznesi
 - Investime të huaja ose të ardhura, ose
 - Transaksione financiare me anëtar të familjes ose persona tjerë të afërt.
- Të gjitha këto incidente mund të jenë një indikator që pasuria është përfituar në konflikt të interesave në pozitën shtetërore (ndryshimi i favorshëm i zonës së tokës, prokurime të favorshme, etj.).
- Anëtarë të **familjes** që kanë në pronësi biznese;
 - Zyrtari publik që më herët ka qenë pronar i **bizneseve** ose që ka punuar në sektorin privat në funksione udhëheqëse;

- Pozita **me rrezik të lartë** (prokurime, resurse njerëzore, licenca, subvencione, pothuaj se gjithkund ku shteti shpërndan resurse të kufizuara/ku qytetarët garojnë për të qenë të zgjedhur);
- Agjencia publike që angazhon ka firmosur kontrata me kompani **të huaja**.

5 Kë duhet të kërkojmë: aktorë për zbulimin e konfliktit të interesave

Nga perspektiva strategjike e vendosjes së një sistemi funksional kombëtar për zbulimin e konfliktit të fshehur të interesave, dy gjëra janë të rëndësishme:

- Një organ (i centralizuar) që mund dhe nuk duhet të jetë i vetmi përgjegjës për zbulimin e konfliktit të interesave;
- Të gjithë aktorët duhet të kenë udhëzime të qarta për rolin e tyre në zbulimin e konfliktit të interesave.

Shpeshherë, zbrazëtira në zbulimin e konfliktit të interesave në praktikë duket si kjo më poshtë:



5.1 Organe që verifikojnë deklaratatë të pronave/interesave

Komisione të etikës ose agjenci anti-korrupsioni zakonisht janë ato përgjegjës për verifikimin e deklaratave vjetore të pronave/interesave të zyrtarëve publik. Këto trupa kanë rolet vijuese për zbulimin e konfliktit të fshehura të interesave:

- Kontrollimi i deklaratave vjetore për **kompletimin** e të dhënave; në raste të të dhënave të pakompletuara, informojnë punëdhënësin për të filluar një revizion të hollësishëm të konfliktit të interesave (përveç nëse komisioni i etikës ose agjencia anti-korrupsion ka fuqinë për të zhvilluar këto revizione duke kontrolluar dokumentet në vendin e punës;
- Zhvillimi kontrollimit i bazuar në Pikat e Nisjes 1 dhe 2 të strategjisë së kërkimit për një sërë zyrtarësh publik (shikoni Kapitullin 4) duke përdorur gjitha të dhënat e trupit të mbikëqyrjes që ka në dispozicion (**të dhënat e hapura** si dhe bazat me të dhëna publike dhe private).

5.2 Mbikëqyrësit

Të gjithë mbikëqyrësit duhet **në mënyrë aktive** të mbikëqyrin stafin e tyre.²⁴ Kjo nënkupton që ata duhet

- një kuptim të gjerë të **deklaratës së pronave/interesave** të secilit anëtar të stafit dhe interesat private të zbuluara nga ky moment si dhe për detyrat e secilit prej anëtarëve të stafit;
- në baza të rregullta të kontrollohet një **mostër** e vendimeve nga anëtarët e stafit për çdo transaksion që ka dyshime për përfshirjen e interesave privat.

5.3 Kontrollimi i brendshëm

Njësitë e kontrollit/inspektimit të brendshëm duhet të kenë qasje në deklaratat e pronave/interesave dhe duhet të zhvillojnë strategjinë e kërkimit të përmendur më lartë (Kapitulli 3) mbi një përzgjedhje të zyrtarëve publik (shikoni Kapitullin 4) duke përdorur të dhënat e gatshme që ka njësitë e revizionit në qasje (**dosjet e punës**, të dhënat e hapura si dhe bazat me të dhëna private dhe publike).²⁵

5.4 Revizorë të jashtëm

Gjykata e revizorëve duhet të përfshijë **një procedurë standarde** për zbulimin e konfliktit të interesave në rregullat e tyre të revizionit. Ata çdoherë duhet të kontrollojnë një mostër të vendimeve dhe të zbatojnë Hapat 1 dhe 2 të strategjisë së kërkimit (Kapitulli 3).

²⁴ Komisioni i Pavarur kundër Korrupsioni (ICAC), Nju South Uells (Australi), ueb faqja për: Parandalimi i korrupsionit > Zbulimi i veprave korruptuese > Mbikëqyrja dhe kontrolli, <https://www.icac.nsw.gov.au/preventing-corruption/detecting-corrupt-conduct/supervision-and-checking/4883Keshi>.

²⁵ Shikoni ICAC, Roli i revizionit të brendshëm dhe kontrollit të punës për zbulimin e korrupsionit: "Agjencitë duhet të kenë procese të revizionit dhe kontrollit të punës në vend që janë të gatshme për të zbuluar llojet e sjelljes së korrupsionit të identifikuar nga agjencia në procesin e identifikimit të rrezikut.", <https://www.icac.nsw.gov.au/preventing-corruption/detecting-corrupt-conduct/internal-audit-and-work-review/1534>

5.5 Shoqëria civile

Gazetarë, OJQ, dhe/ose qytetarë të interesuar mund të zbatojnë Hapat 1 dhe 2 të strategjisë së kërkimit në çdo kohë duke përdorur të dhënat në të cilat kanë qasje: të dhëna të hapura si dhe baza me të dhëna publike dhe private, si dhe dosje që mund të gjejnë (kopje të dosjeve të punës nga ndonjë informator).

6 Me pak fjalë: 10 parimet

10 parimet për revizione efektive të konfliktit të interesave

1. Trupat shtetëror përgjegjës për mbikëqyrje nuk duhet vetëm **të presin për ankesa** por duhet të kenë mekanizma përkatës në vend për **zbulimin aktiv** të konfliktit të interesave.
2. Verifikimi i **deklaratave vjetore** për kompletim është një procedurë por edhe një revizion i konfliktit të interesave nuk mjafton.
3. Një revizion duhet të **hartojë** gjitha **interesat privat** të zyrtarëve përkatës publik që janë të njohur dhe që mund të kërkohen.
4. Interesat private mund të fshihen mes personave natyral dhe ato ligjor; andaj, duhet të kërkohen gjitha interesat private veçanërisht kur ka të përfshirë **persona ligjor** (“asnjëherë mos ndaloni eksplorimin”).
5. Një revizion duhet të përdor **të dhëna të hapura** dhe gjitha bazat me të dhëna të gatshme për kërkimin e interesave private.
6. Trupat shtetëror përgjegjës për mbikëqyrjen duhet të sigurojnë qasje në të dhënat nga **jashtë vendit** për të hartuar interesat private të fshehur pas aktorë të huaj.
7. Të gjithë trupat publik duhet rregullisht të bëjnë revizion të **një mostre të rastit** të zyrtarëve publik dhe/ose dosjeve publike për indikacione të konfliktit të interesave.
8. Siç vetëm më bëhet në sektorin privat, revizionet duhet të përdorin **veçat e kërkimit elektronik** për kërkimin e të dhënave (për identifikimin e përputhjeve

mes dosjeve të punës dhe interesave private).

9. Revizionet asnjëherë nuk mund të jenë detyrë e vetëm një trupi shtetëror (qendror); duhet të përcaktohet roli i qartë për **secilin aktor** duke mos lënë asnjë zbrazëtirë, posaçërisht duke përfshirë mbikëqyrësit, njësitë e revizionit të brendshëm si dhe gjykatën e revizoreve (të jashtëm).
10. Revizionet duhet të bëhen në bazë të një **strategjie kërkimi** të shkruar dhe gjithë aktorët duhet të trajtohen në mënyrë përkatëse për këtë strategji.